

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Nga Kruja inaugurojmë Foltoren e Ripërtëritjes"/ Berisha: Koha na thërret t'i japim zgjidhje kësaj gjendje dramatike
ADRESA	https://dosja.al/politike/nga-kruja-inaugurojme-foltoren-e-riperteritjes-berisha-koha-na-therret--i514502
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:18:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4828daac5de2be7026f39463c4240178906e1afa062b4f08e46d03a8ed1034e2
TEKSTI	57e8dea82c8fdaf46b6001e433ad86038cfe3e45a6dff4fb0919a12da05fb314
PAMJA	dc76a4f99d6d741d8578d7c9cdf86d8350ad7207251ddb5d9992f52e3e403ca

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f20585dec0ebe44e47479316886dedaacdb4b190765a5355045a8ea26b9a669a
E MËPARSHMJA	177e28d8c24dde7863a6ca8c7ff349673c6201105a2c16b06ad3e07ca28717cf
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f20585dec0ebe44e47479316886dedaacdb4b190765a5355045a8ea26b9a669a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

1 ORE ME PARE

Dita e 109-të e protestës kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh, paralajmërojnë marshim drejt Parlamentit

8 ORE ME PARE

Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë

12 ORE ME PARE

Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi

23 ORE ME PARE

SYTË NGA HAGA/ Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së, rrugët mbushen me flamuj e mbishkrime për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin: Shpallini të pafajshëm (PAMJET)

Politike

"Nga Kruja inaugurojmë Foltoren e Ripërtëritjes"/ Berisha: Koha na thërret t'i japim zgjidhje kësaj gjendje dramatike

Në fjalën e tij, Berisha vlerësoi drejtuesin e degës Aulon Kalaja, duke e cilësuar si pararendës të procesit të ripërtëritjes së PD-së.

dosja

16 Shtator 2026, 19:05
Nga G.M



Sali Berisha

KRUJË-Lideri i Partisë Demokratike Sali Berisha, ka marrë pjesë ditën e sotme në Kuvendin e degës së Krujës, ku ka deklaruar se nga ai qytet do të nis 'Foltorja e Ripërtëritjes' së partisë. Në fjalën e tij, Berisha vlerësoi drejtuesin e degës Aulon Kalaja, duke e cilësuar si pararendës të procesit të ripërtëritjes së PD-së.

Njëkohësisht ai kritikoi ashpër qeverisjen e Edi Ramës, duke e akuzuar për përkeqësimin e gjendjes ekonomike dhe demografike të vendit. Ai tha se largimi i shqiptarëve, rënia e lindjeve dhe rritja e kostos së jetesës janë ndër problemet kryesore me të cilat përballet vendi.

"Demokrate dhe demokratë të Krujës, qytetare dhe qytetarë të këtij qyteti të bekuar, një përshëndetje shumë të përzemërt dhe nderimn me të madh, mirënjohjen me të pakufishme ndaj jush. Por, të dashur aleatë, të dashur deputetë, drejtues i qarkut të Durrësit, anëtarë kryesie, deputet i zonës, deputetë të Durrësit, sot jemi këtu në një ngjarje, në një eveniment shumë të rëndësishëm të demokratëve të Krujës, por dhe të kryetarit të kësaj dege, Aulon Bej Kalaja, të cilin unë duhet ta përgëzoj shumë përzemërsisht. Aulon Kalaja, të themi të vërtetën, u bë pararendësi i atij procesi, i procesit të ripërtëritjes së PD, kaq jetik dhe vendimtar për fatin e kësaj partie, kaq jetik dhe vendimtar për fatin e vendit. Në këtë kuadër, unë duhet t'u them një të vërtetë ju: në axhendën time ekzistonte, ta quajmë Foltorja e Ripërtëritjes, por kam kënaqësi që këtë veprimtari, këtë përpjekje të re, e inaugurojmë këtu në Krujë.

Dhe nuk ka një vend të dytë ku mund të frymëzojë më shumë se Kruja për një përpjekje të madhe. Miq, ne si PD

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 16:18

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 12:46

DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të ish-krerëve të UÇK-së

kaluam periudha jo të lehta. Por ne sot nuk mund të mburremi as me ato që kaluam, as me ato që bëmë në të shkuarën. Sot koha na thërrret t'i japim përgjigje kësaj gjendje dramatike, t'i japim zgjidhje kësaj rrokullisje të madhe, kësaj gjendje dramatike në të cilën e ka katandisur regjimi i Edi Ramës, Shqipërinë dhe shqiptarët. Nuk ka pushtim në histori, që t'i ketë dhënë një goditje më të rëndë qenies shqiptare se sa Edi Rama në 10 vite. Në 10 vite, 47 përqind e shqiptarëve u larguan nga Shqipëria për një shkak madhor, për shkak të vendimit të tij për t'u pasuruar në mënyrë të çmendur, të paligjshme.

Për shkak të shndërrimit të financave tuaja, të taksave që paguani jo në rroga, jo në pensione, jo në infrastrukturë, jo në shërbime, spitale e shkolla, por në llogari bankare të fshehura në bankat offshore. Sot qytetari shqiptar nuk mund të imagjinojë, dhe unë njerëzisht u kërkoj ta kujtoni këtë fjalë, se koha do provojë se çfarë Edi Rama u ka bërë shqiptarëve. Asnjë pushtues i egër nuk është sjellë ky ndaj pasurive publike të këtij vendi dhe fondeve. Në një akt amoraliteti total, të vendosur për të plaçkitur gjithçka dhe çdo gjë, pa asnjë kufi, kanë krijuar format më të pabesueshme të vjedhjes së qytetarëve shqiptarë, djersës së tyre të ballit, të vjedhjes së pasurive publike, të shndërrimit të Shqipërisë në një çiflig hajnash që përzënë çdo ditë shqiptarët. Ky shok demografik është goditja më e tmerrshme që kemi marrë ne nga çdo luftë.

Kurrë ndonjëherë nuk jemi pakësuar në atë shkallë sa lindjet tona të zbresin në ato të 100 viteve më parë. Asnjëherë nuk është e regjistruar si sot. Unë e kam përjetuar, kam qenë mjek, dhe t'u them të vërtetën ju, e përjetoja me shumë dhembshuri urinë kronike dhe varfërinë ekstreme të njerëzve kur unë u jepja recetën dhe ata nuk e mermin sepse nuk i blinin dot ilaçet. Kur zona të tëra masive mermin 1 kg sheqer, bukën dhe 1 kg kripë dhe përjetonin sëmundjen. Atëherë se ishte vendosur hiperkolektivizmi total, i çmendur. Por sot të jemi të sigurt që janë dhjetëra mijëra shqiptarë që numërojnë kafshatën. Që me atë pension që marrin, nuk sigurojnë dot ushqimin normal të dy javëve. Me atë pension që marrin, shkojnë në dyqan dhe gjejnë çmime më të shtrenjta se në Dallas, se në Nju Jork, se në Berlin, se në Romë," tha Berisha./Dosja.al

salë berisha

Sondazh

Poll

Politike

16 Shtator 2026, 18:59

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Vuçiç reagon nga Beogradi: Nuk u dënuan për krime kundër njerëzimit

Presidenti serb Aleksandar Vuçiç SERBI- Presidenti serb Aleksandër Vuçiç ka reaguar pas vendimit të Dhomave të S...

Çështja 'Balluku', paraqiten në SPAK vëllezërit Alban dhe Olsi Eftimi

Politike

16 Shtator 2026, 18:48

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 12:40

"Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë u prit në lot nga qytetarët" / Reuters: Vendimi u ndoq nga afër edhe Serbi

më të klikuarat

Përgjimet dhe akuzat për tregti armësh, reagon kompania ku u përgjuan: Ron Yeffet nuk na përfaqëson, përgjimi ishte i paautorizuar

VIDEO/ Biznesmeni Samir Mane paraqitet në Prokurorinë e Posaçme

Tensione para Dhomave të Specializuara në Hagë/ Protestuesit përplasen me policinë holandeze: Largohuni ose do përdorim forcën (VIDEO)

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.

Dosja e AKSHI-t/ Mirlinda Karçanaj dhe 4 persona të tjerë kërkojnë zhbllokimin e pasurive të sekuestruara

Politike

16 Shtator 2026, 18:38

Vendimi i Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Grenell i përgjigjet Marta Kosit: Kjo nuk është drejtësi, Evropa të mbyllë këto gjykata radikale

Politike

16 Shtator 2026, 18:19

"Dënimi i Thaçit është skandaloz"/ Richard Grenell kërkon mbylljen e Gjykatës Speciale: Kurti të veprojë menjëherë

Politike

16 Shtator 2026, 18:14

Politike

16 Shtator 2026, 17:58

‘Territorialja’/ Rama: Maliqi mbetet qytet, do rriten investimet. Peleshi: Dëgjesat të domosdoshme

Edi Rama KORÇË- Kyeministri Edi Rama zhvilloi ditën e sotme takimin e radhës në kuadër të Reformës së re Ter...

Dënimi i liderëve të UÇK-së/ Reagon Nik Gjeloshaj: Vendim jashtëzakonisht i padrejtë

Politike

16 Shtator 2026, 17:41

Dënimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë/ Reagon Marta Kos: Vendimet e Gjykatës duhet të respektohen, bëhet fjalë për individë individualë

Politike

16 Shtator 2026, 17:30

"Marre"/ Pas dënimit të Thaçit, Ramën e masakrojnë komentuesit në rrjetet sociale: Dikur udhëtove me helikopter për t'i bërë presin të votojë pro krijimit të Speciales

Politike


16 Shtator 2026, 17:26

Vendimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë: Historia e Kosovës nuk rishkruhet

Politike

16 Shtator 2026, 17:19

MË SHUMË



Të shtënat me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një avokat, policia në kërkim të autorit

Shiko video te tjera

Të shtënat me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një avokat, policia në kërkim të autorit

Biznesmeni Samir Mane paraqitet në Prokurorinë e Posaçme

Pamje prekëse nga Prishtina/ Polici shpërthen në lot kur protestuesit i vendosin pranë flamurin

Haga dënon ish krerët e UÇK-së me 81 vite burg, vogëlushi shpërthen në lot



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEDIORESCAP INGA Mediasdesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.